



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 1216/8 prot.

Datë 19/09/2023

**V E N D I M**

**Nr.922/2023**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 19.09.2023 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave lidhur me skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “A & E ENGINEERING” SHPK në procedurën e prokurimit “*Shërbim Konsulence*”, me Nr. REF-64347-03-30-2023, me objekt: “*Supervizion punimesh “Ndërtim rruga Berat - Ballaban, Loti 3”*”, me fond limit 17.674.151,09 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 18.04.2023 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “A & E ENGINEERING” SHPK me NIPT: K72113010E dhe me adresë: Rruga “*Islam Alla*” Pallati “IVEA 3/5”, Tiranë.

**Autoriteti Kontraktor:** Autoriteti Rrugor Shqiptar  
Adresa: “Rruga Sami Frashëri nr.33”, Tiranë.

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të*

*Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## **V ë r e n:**

### **I**

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

### **II**

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 31.03.2023, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “*Shërbim Konsulence*”, me Nr. REF-64347-03-30-2023, me objekt: “*Supervizion punimesh “Ndërtim rruga Berat - Ballaban, Loti 3”*”, me fond limit 17.674.151,09 lekë pa TVSH zhvilluar më datë 18.04.2023 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

II.2. Në datë 18.04.2023 referuar sistemit elektronik të prokurimit (SPE) rezulton, se autoriteti kontraktor ka zhvilluar fazën e parë të procedurës së mësipërme të prokurimit (*shprehja e interesit*) nga verifikimi i së cilës rezulton, se kanë shprehur interes operatorët ekonomikë si më poshtë cituar:

1. “Consulting & Management Albania” SHPK
2. “C.E.C Group” SHPK
3. “ZENIT & CO” SHPK
4. “MCE” SHPK
5. “CIVIL CONS” SHPK
6. “GR ALBANIA” SHPK
7. “DRICONS” SHPK
8. “INFRATECH” SHPK
9. “AVE CONSULTING” SHPK
10. “IMES-D” SHPK
11. “ARENA MK” SHPK
12. “INVICTUS” SHPK
13. “A & E ENGINEERING” SHPK
14. “A.SH. Engineering” SHPK
15. “TOWER” SHPK

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), rezulton, se në datën 24.05.2023, autoriteti kontraktor ka zhvilluar fazën (*short-listing*), duke njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës mbi vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit mbi rezultatet e vlerësimit të ofertave si më poshtë:

- |   |                     |
|---|---------------------|
| 1. “Consulting & Management Albania” SHPK | <i>skualifikuar</i> |
| 2. “C.E.C Group” SHPK                     | <i>skualifikuar</i> |
| 3. “ZENIT & CO” SHPK                      | <i>skualifikuar</i> |
| 4. “MCE” SHPK                             | <i>skualifikuar</i> |
| 5. “CIVIL CONS” SHPK                      | <i>kualifikuar</i>  |
| 6. “GR ALBANIA” SHPK                      | <i>skualifikuar</i> |
| 7. “DRICONS” SHPK                         | <i>skualifikuar</i> |
| 8. “INFRATECH” SHPK                       | <i>skualifikuar</i> |
| 9. “AVE CONSULTING” SHPK                  | <i>skualifikuar</i> |
| 10. “IMES-D” SHPK                         | <i>skualifikuar</i> |
| 11. “ARENA MK” SHPK                       | <i>skualifikuar</i> |
| 12. “INVICTUS” SHPK                       | <i>kualifikuar</i>  |
| 13. “A & E ENGINEERING” SHPK              | <i>skualifikuar</i> |
| 14. “A.SH. Engineering” SHPK              | <i>skualifikuar</i> |
| 15. “TOËER” SHPK                          | <i>skualifikuar</i> |

II.4. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), rezulton, se në datën 24.05.2023 autoriteti kontraktor ka zhvilluar fazën (*short-listing*) duke njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës mbi vendimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për përzgjedhjen e kandidatëve

pas fazës së parakualifikimit mbi rezultatet e vlerësimit të ofertave, duke skualifikuar ofertën e operatorit ekonomik “A & E ENGINEERING” SHPK, me arsyetimin si më poshtë:

*“OE ‘A&E ENGEENERING’ nuk kualifikohet mbasi nuk plotëson kriteret e DST dhe konkretisht:*

*2.3.3.Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, si më poshtë:*

*Një pjesë e stafit është i angazhuar në kontratat në zbatim në ARRSH.”.*

II.5. Në datën 29.05.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2023/3137, date 29.05.2023 dhe nr. protokollit 1216/2023, datë 29.05.2023 e operatorit ekonomik “A & E ENGINEERING” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit, duke kundërshtuar vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “A & E ENGINEERING” SHPK në fazën (*short-listing*), duke pretenduar si më poshtë vijon:

*“Arsyeja e refuzimit të operatorit tonë ekonomik na duket pa bazë ligjore, pasi në asnjë Ligj apo Vendim të Procedurave të Prokurimit Publik nuk kërkohet një kusht i tillë, që stafi i angazhuar në një objekt nuk mund të përdoret për procedura të tjera prokurimi.*

*Bazuar Kontratave me ARRSH-në, ku ne jemi në rolin e mbikëqyrësit, njëra prej tyre është në pezullim punimesh që prej dt. 29.04.2022. Nisur nga ky fakt dhe duke mos patur një datë të papërcaktuar për rifillimin e punimeve ne i jemi drejtuar disa herë ARRSH-së në mënyrë zyrtare me shkresë përcjellëse, duke kërkuar lirimin e stafit të angazhuar deri në rifillimin e punimeve, sepse na duket jo i drejtë që stafi të qëndroj pezull dhe i paangazhuar në kontrata tjera. Shkresat e depozituara në protokoll drejtuar ARRSH-së janë:*

*1. Shkresa Nr.1178 Prot. datë 28.10.2022 (Propozim për lirimin e stafit mbikëqyrës)*

*2. Shkresa Nr.485 Prot. datë 11.05.2023 (Rikërkesë për lirim të stafit mbikëqyrës) Bazuar kërkesave tona të njëpasnjëshme ndaj Autoriteti Rrugor Shqiptar, sot me datë 29.05.2023 kemi marrë një përgjigje zyrtare të vonuar në lidhje me njërën nga dy shkresat e depozituara në protokollin e institucionit. Por edhe fakti që një inxhinier mbikëqyrës, i angazhuar në masën 10-15% të kohëzgjatjes së zbatimit të Kontratës, nuk duhet të jetë i përfshirë në një procedurë tjetër po në masë të ulët angazhimi është marrë nga ARRSH-ja arsye për skualifikimin nga procedura duket jo i drejtë sepse eksperti planifikon të ndjekë punimet sipas grafikëve të punimeve të kontratave të caktuara. Ku sipas grafikëve të punimeve ky ekspert mund të planifikojë të ndjekë punimet në dy kontrata njëkohësisht.”.*

II.6. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit nr. 1216/2 prot., datë 30.05.2023 lidhur

me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e operatorit ekonomik ankimues “A & E ENGEENERING” SHPK.

II.7. Me shkresën me nr. 4567/3 prot., datë 02.05.2023, protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 1216/3 prot., datë 07.06.2023, autoriteti kontraktor ka paraqitur informacion mbi trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “A & E ENGEENERING” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.8. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor rezulton, se ky i fundit e ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik “A & E ENGEENERING” SHPK, duke mos e pranuar atë me pretendimin si më poshtë vijon:

*“... Më datë 18.04.2023, ora: 10:00 është hapur faza e I (pranimi i kërkesave për pjesëmarrje). Autoritetit Kontraktor më datë 24.05.2023 ka bërë vlerësimin mbi përzgjedhjen/kualifikimet e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë, të cilët e kanë marrë këtë njoftim në Sistemin e Prokurimit Elektronik.*

*Më datë 30.05.2023 pranë autoritetit kontraktor është regjistruar ankesa nr. 4567 prot, bërë nga operatori ekonomik “A & E ENGEENERING” SHPK.*

*Në zbatim të nenit 96 të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, personi përgjegjës për prokurim konfirmoi nëse ankesa është publikuar edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Ankesa rezulton e publikuar. Autoriteti kontraktor pas njohjes me të gjithë dokumentacionin dhe verifikimin në sistem, ju bën me dije si më poshtë:*

...

*Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur në këtë ankesë është vërejtur se:*

*Në DST 6 kësaj procedurë sipas pikës 2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, si më poshtë:*

*1. Drejtuesin e projektit, që duhet të jetë inxhinier ndërtimi/strukturist me licence ...*

*2. Mbikëqyrësin për punimet topografike, që duhet të jetë inxhinier topograf/geodet me licencë*

...

*3. Mbikëqyrësin (gjeolog), duhet të jetë inxhinier gjeolog me licencë ...*

*4. Mbikëqyrësin për punimet e sinjalistikës, që duhet të jetë inxhinier mekanik me licencë ...*

*5. Mbikëqyrësin për punimet e drenazhimit dhe mbrojtjes lumore, që duhet të jetë inxhinier hidroteknik me licencë ...*

*6. Mbikëqyrësin për punimet e mjedisit, që duhet të jetë inxhinier mjedisi me licencë ...*

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 12.*

*Nga operatori ekonomik “A & E Engineering” ShPK, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit për këtë procedurë është paraqitur stafi kryesor si më poshtë:*

*Drejtues Projekti- Inxhinier Ndërtimi/strukturist – M. H*

*Mbikëqyrës për punimet topografike – F. D*  
*Mbikëqyrës për punimet gjeologjike – V. A*  
*Mbikëqyrës për punimet e sinjalistikës – K. D*  
*Mbikëqyrës për punimet hidroteknike – E. C*  
*Inxhinier për punimet e mjedisit – A. Kurti, E. Sh*

*Pra, është evidentuar angazhimi i një pjese të stafit të paraqitur për këtë procedurë në kontrata të tjera të lidhura midis ARRSh dhe Operatorit Ekonomik “A & E Engineering” si më poshtë:*

*1. Drejtuesi Projektit Inxhinier Ndërtimi/strukturist – M. H, është i angazhuar në kontratën “Supervizion Punimesh Ndërtim Rruga Korçë - Ersekë Loti 2 (pjesa e dytë), objekt i cili aktualisht është në proces ndërtimi dhe punimet ecin me ritme të kënaqshme. Në ankesën tuaj ju nuk jeni shprehur në asnjë pjesë për këtë inxhinier të angazhuar dhe për këtë objekt, rrjedhimisht arsyeja e skualifikimit nga ana juaj konsiderohet e pranuar.*

*2. Mbikëqyrës për punimet topografike – F. D, është i angazhuar në kontratën “Plotësimi, rakordimi dhe vazhdimi i punimeve Sheshi Shqiponja - Lumi i Tiranës, Loti 1 dhe QMT”, siç e pranoni dhe ju në ankesën tuaj. Ky objekt është pezulluar më datë 29.04.2022 për shkak të disponimit të sheshit të ndërtimit dhe punimet do të rifillojnë sapo të përfundojë problematika e shpronësimeve. Aktualisht VKM-ja e shpronësimeve është publikuar, problematika e shpronësimeve konsiderohet e zgjidhur dhe punimet priten të rifillojnë sipas grafikut të punimeve.*

*Gjithashtu, duke ju referuar edhe Procesverbalit të pezullimit të punimeve të mbajtur midis palëve me datë 29.04.2022 në paragrafin e fundit citohet:*

*“3. Pezullon:*

*Vazhdimin e punimeve në objekt kundrejt zgjatjes korresponduese të afatit të parashikuar në kontrate. Gjatë kësaj kohe kantieri do të mbahet në ruajtje nga Sipërmarrësi i Punimeve dhe do të inspektohet bashkërisht nga Mbikëqyrësi dhe Sipërmarrësi për të vlerësuar mundësitë e rifillimit të punimeve.”*

*3. Inxhinieri për punimet e mjedisit- A .K, është i angazhuar në kontratën “LOTI 4 - KONTRATA "Supervizion mirëmbajtje me performance e akseve kryesore të Rajonit Jugor" siç e pranoni dhe ju në ankesën tuaj. Ky objekt aktualisht është në proces zbatimi.*

*Nga shoqëria juaj, në formularin e vetdeklarimit për të gjithë objektet e sipërpërmendura keni vetdeklaruar stafin e konsulentit për zbatimin e objekteve dhe secili prej anëtarëve ka paraqitur deklaratën mbi disponueshmërinë për realizimin e objektit sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor. (bashkëngjitur deklaratat mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit të konsulentit).*

*Gjatë periudhës së zbatimit të objektit duke iu referuar kontratave të lidhura me Autoritetin Rrugor Shqiptar neni 16 - Heqja dhe zëvendësimi i Personelit Kryesor, ju mund të hiqni dhe zëvendësoni personelin kryesor duke siguruar aprovim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues përpara heqjes apo zëvendësimit të personelit kryesor sipas kushteve të këtij neni dhe jo të lironi të gjithë stafin mbikëqyrës të objektit, deri në përfundimin e plotë të kontratës.*

*Objekti konsiderohet i përfunduar vetëm me njoftimin e përfundimit të punimeve nga ana e Mbikëqyrësit dhe Sipërmarrësit të punimeve.*

*Për sa më sipër, ankesa e paraqitur nga operatori ekonomik “A & E Engineering” ShPK për procedurën me objekt “Supervizion punimesh Ndërtim rruga Berat-Ballaban, Loti 3”, me fond limit 17,674,151.09 (shtatëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e shtatëdhjetë e katër mijë e njëqind e pesëdhjetë e një presje zero nëntë) Leke pa-TVSH, me REF-64347-03-30-2023, nuk është pranuar, bazuar në parashikimet e Nenit 92 të Ligji nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe Nenit 82, pika 2 VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.*

II.9. Komisioni i Prokurimit Publik me qëllim gjykimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe shqyrtimit të të gjitha fakteve dhe rrethanave, me anë të shkresës nr. 1216/4 prot., datë 29.06.2023, “Kërkesë për paraqitje dokumentacioni lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “A & E ENGINEERING” SHPK”, i kërkoi autoritetit kontraktor të paraqesë pranë KPP dokumentacionin si në vijim: “Kontratën “Supervizion Punimesh Ndërtim Rruga Korçë - Ersekë Loti 2 (pjesa e dytë); Kontratën “Plotësimi, rakordimi dhe vazhdimi i punimeve Sheshi Shqiponja - Lumi i Tiranës, Loti 1 dhe QMT” dhe Kontratën ‘Supervizion mirëmbajtje me performance e akseve kryesore të Rajonit Jugor’.”.

II.10. Me shkresën me nr. 5610/1 prot., datë 04.07.2023, protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 1216/5 prot., datë 05.07.2023, autoriteti kontraktor ka paraqitur informacion e kërkuar me shkresën nr. 1216/4 prot., datë 29.06.2023, të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e mësipërme të prokurimit.

II.11. Komisioni i Prokurimit Publik me qëllim gjykimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues dhe shqyrtimit të të gjitha fakteve dhe rrethanave, me anë të shkresës nr. 1216/6 prot., datë 19.07.2023 “Kërkesë për paraqitje dokumentacioni lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “A & E ENGINEERING” SHPK”, i kërkoi autoritetit kontraktor të paraqesë pranë KPP informacionin, si më poshtë vijon:

[...]

- 1. A kanë ndryshuar kushtet e kontratave të sipërpërmendura?*
- 2. A ka ndryshime në stafin e angazhuar nga ana e kontraktuesit “A & E ENGINEERING” SHPK në kontratat e sipërpërmendura?*
- 3. Të vihen në dispozicion të Komisionit të Prokurimit Publik aktet ligjore dhe nënligjore që zbatohen për supervizionin dhe mbikëqyrjen e kontratave publike të punëve civile. [...].*

II.12. Me shkresën me nr. 6166/1 prot., datë 25.07.2023, protokolluar pranë Komisionit të Prokurimit Publik me nr. 1216/7 prot., datë 27.07.2023, autoriteti kontraktor ka paraqitur informacion e kërkuar me shkresën nr. 1216/6 prot., datë 19.07.2023 të Komisionit të Prokurimit Publik, për procedurën e mësipërme të prokurimit, si më poshtë vijon:

“Në përgjigje të kërkesës Tuaj Nr.1216/6 prot, datë 19.007.2023, protokolluar me Tonën Nr. 6166 Prot, datë 20.07.2023, me lëndë “Kërkesë për paraqitje dokumentacioni lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “A & E ENGINEERING” sh.p.k, si dhe në përgjigje të pyetjeve Tuaja:

1. A kanë ndryshuar kushtet e kontratave të sipërpërmendura?

Në datën 05.07.2023, me shkresën nr. 5610/1 prot, autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar ju ka venë në dispozicion dokumentacionin e mëposhtëm për Kontratën Supervision punimesh “Ndërtim Rruga Korçë — Ersekë Loti 2 (pjesa e dytë), Kontratën Supervision punimesh “Plotësimi, rakordimi dhe vazhdimi i punimeve Sheshi Shqiponja- Lumi i Tiranës, Loti 1 dhe QMT” dhe Kontratën Loti 4: Kontrata D “Supervision mirëmbajtje me performancë e akseve kryesore të Rajonit Jugor”. Në përgjigje të pyetjes tuaj, ju informojë që kushtet e kontratave të sipërpërmendura nuk kanë ndryshuar.

2. A ka ndryshime në stafin e angazhuar nga ana e kontraktuesit “A & E ENGINEERING” SHPK në kontratat e sipërpërmendura?

Autoriteti kontraktor në zbatim të nenit 16 “Heqja dhe Zëvendësimi i Personelit Kryesor” pika 3 “Nëse bëhet e nevojshme të zëvendësohet ndonjë nga personeli kryesor, Furnizuesi duhet të sigurojë si zëvendësues një person me kualifikime ekuivalente ose më të mira.”, të kontratës së nënshkruar midis palëve dhe duke marrë në konsideratë dokumentacionin e paraqitur nga ana e OE, ka dhënë aprovimin për ndryshimin e stafit të angazhuar nga ana e kontraktuesit “A & E ENGINEERING” Sh.p.k, në kontratat Supervizion punimesh “Plotësimi, rakordimi dhe vazhdimi i punimeve Sheshi Shqiponja- Lumi i Tiranës, Loti 1 dhe QMT” dhe kontratën Loti 4: Kontrata “Supervision mirëmbajtje me performancë e akseve kryesore të Rajonit Jugor”, bashkëlidhur do të gjeni dokumentacionin mbi ndryshimet e propozuara nga ana e OE dhe miratimin nga ana e AK-së.

3. Të vihen në dispozicion të Komisionit të Prokurimit Publik aktet ligjore dhe nënligjore që zbatohen për supervizimin dhe mbikëqyrjen e kontratave publike të punëve civile

Baza ligjore të cilën Autoriteti Rrugor Shqiptar zbaton për supervizimin dhe mbikëqyrjen e kontratave publike të punëve civile është: Ligji Nr.8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, (Ndryshuar me Ligjin nr. 9200, datë 26.02.2004), (Ndryshuar me Ligjin nr.9794, datë 23.07.2007), (Ndryshuar me Ligjin nr.9826, datë 11.11.2007), (Ndryshuar me Ligjin nr.10324, datë 23.09.2010), (Ndryshuar me Ligjin nr.11/2012, datë 09.02.2012), (Ndryshuar me Ligjin nr.20/2013, datë 14.02.2013), ligjin Nr. 120/2020 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar dhe Udhëzimi Nr.3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, i përditësuar. “.

II.13. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime



nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113, të ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik.

### **III Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

#### **Arsyeton**

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “A & E ENGINEERING” SHPK, mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyen se: “OE “A&E ENGEENERING” nuk kualifikohet mbasi nuk plotëson kriteret e DST dhe konkretisht: 2.3.3.Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, si më poshtë:Një pjesë e stafit është i angazhuar në kontratat në zbatim në ARRSH.” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në dokumentet e tenderit, Shtojcën 11 “Formulari i Kriereve Të Përzgjedhjes/Kualifikimit ” Pika 2.3.3 “Kriteret E Veçanta Të Kualifikimit” autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin kualifikues, si më poshtë:

“2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt-kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, si më poshtë:

1. Drejtimesin e projektit, që duhet të jetë inxhinier ndërtimi / strukturist me licencë dhe me eksperiencë pune në mbikëqyrje, i cili mban përgjegjësi për zbatimin e projektit sipas kushteve teknike të zbatimit, miratimin e volumeve të punimeve, miraton materialet dhe cilësinë e tyre, certifikatën e pagesës, mbajtjen, kontrollin dhe miratimin e gjithë dokumentacionit, miratimin e ndryshimeve të volumeve, ndjek e miraton cilësinë e punimeve nga pikëpamja strukturore, si dhe mban korrespondencën me ARRSH-në.

2. Mbikëqyrësin për punimet topografike, që duhet të jetë inxhinier topograf / gjeodet me licencë dhe me eksperiencë pune në këtë fushë, i cili kontrollon dhe miraton volumet, piktetimet dhe kuotëzimin e objektit.

3. Mbikëqyrësin (gjeolog), duhet të jetë inxhinier gjeolog me licencë dhe me eksperiencë pune në këtë fushë, i cili kontrollon bazamentin e punimeve të mbushjes, skarpatat e punimet gjatë gërmimit, hapjet dhe thellësinë e themeleve të veprave të artit.

4. Mbikëqyrësin për punimet e sinjalistikës, që duhet të jetë inxhinier mekanik me licencë dhe me eksperiencë pune në këtë fushë, i cili miraton materialet dhe cilësinë e tyre dhe ndjek e miraton

*cilësinë e punimeve të sinjalistikës horizontale e vertikale (të përkohshme dhe të përhershme), si dhe sigurinë rrugore gjatë kryerjes së punimeve dhe pas tyre.*

*5. Mbikëqyrësin për punimet e drenazhimit dhe mbrojtjes lumore, që duhet të jetë inxhinier hidroteknik me licencë dhe me eksperiencë pune në këtë fushë, i cili ndjek e miraton cilësinë e punimeve për drenazhimin e trupit dhe skarpateve të rrugës, veprave të vogla hidroteknike si dhe mbrojtjen lumore.*

*6. Mbikëqyrësin për punimet e mjedisit, që duhet të jetë inxhinier mjedisi me licencë dhe me eksperiencë pune në këtë fushë.*

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 12. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese, si më poshtë:*

*Për secilin pjesëtar të stafit kryesor të mësipërm duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme, Diplomë, Librezë pune, CV, si dhe licencat profesionale për mbikëqyrje për objektin që prokurohet.*

*Shënim: Për efekt të vlerësimit me pikë operatorët mund të ngarkojnë në fazën e parë ose të dytë dokumentacionin e kërkuar lidhur me pikën 2.3.3.*

*\*Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.”.*

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, në Shtojcën 12 në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

**Shtojca 12.**

*(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)*  
**FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT**

Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_ në cilësinë e \_\_\_\_\_ të operatorit ekonomik \_\_\_\_\_ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

**A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik**

<b>Identifikimi</b>	<b>Përgjigjja</b>
---------------------	-------------------

Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	----- --
Numri NIPT/et:	----- ----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	----- -----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	----- ---
E-mail:	----- ---

**B: DEKLARATË**

**Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik**  
(nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin**

<i>Emri i nënkontraktorit të propozuar</i>	<i>NIPT –i</i>	<i>Përqindja e nënkontraktimit</i>	<i>Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t’u nënkontraktuar</i>

- Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik**

<i>Emri (at) e subjekteve</i>	<i>NIPT-i</i>	<i>Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik</i>	<i>Specifiko konkretisht kapacitetin/et</i>

***Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit***

***A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT***

<b><i>Deklarata</i></b>
<p><i>Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv.</i></p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p> <p>_____</p>
<p><i>Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së.</i></p> <p><i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i></p> <p>_____</p>
<p><i>Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë:</i></p> <p>_____</p> <p>_____</p> <p><i>etj.</i></p>

*nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj.*

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*

---

*Operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.*

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*

---

*Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).*

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*

---

*Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së*

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*

---

*Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi.*

*Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.*

*Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme*

---

*Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.*

*Sqarime                      nëse                      vlerësohet                      e                      nevojshme*

---



*në dokumentet bashkangjitur, në detajet e kësaj oferte, janë përfshirë emrat e konkurrentëve, natyra dhe shkaqet e konsultimit, komunikimit, marrëveshjes apo angazhimit (rasti i bashkimit të operatorëve ekonomikë ose nënkontraktimit).*

□

7. Në veçanti, pa kufizuar paragrafët 6. a) dhe 6. b), të përmendur më lart, nuk ka pasur konsultime, komunikime, kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent në lidhje me:
  - a) çmimet ;
  - b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
  - c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
  - d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.
8. Përveç kësaj, nuk ka pasur konsultime, komunikime, marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë, përveç se kur janë deklaruar sipas paragrafit të mësipërm 6. b).
9. Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura me qëllim nga Ofertuesi konkurrentëve të tjerë, në çdo mënyrë qoftë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj ose nëse deklarohen në mënyrë specifike sipas paragrafit 6.b).

### **C: DEKLARATA MBI KONFLIKTIN E INTERESIT**

#### **Deklarata**

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:

Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrat, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e

Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.**

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

#### **D: DEKLARATA Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës**

**Deklarata**



Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik\_\_\_\_\_lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik \_\_\_\_\_nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme\_\_\_\_\_

### ***Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit***

#### **A: DEKLARATË**

***Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:***

<b>Deklarata</b>	<b>Përgjigje</b>
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojnë të gjitha specifikimet teknike dhe termat e referencës, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti/Enti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me shërbimet dhe grafikun e ekzekutimit të përcaktuar nga Autoriteti/Enti kontraktor.	Po [ ] Jo [ ]

#### **B: DEKLARATË**

**Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)**

<b>Deklarata</b>	<b>Përgjigje</b>
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:	<u>Punonjës</u>

<p>Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.</p>	<p>Po [ ] Jo [ ]</p> <p>Nëse, po, numri i punonjësve:</p> <hr/>
	<p>Profili i punonjësve</p> <hr/>
	<p><u>Makineri e mjete</u></p> <p>Po [ ] Jo [ ]</p>
	<p>Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:</p> <hr/>
<p><b>Emri, Mbiemri</b> _____</p> <p><b>Firma</b> _____</p> <p><b>Vula</b> _____</p> <p><b>Data e dorëzimit të deklaratës</b> _____</p>	

*Ju lutemi sigurohuni që:*

- *Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.*
- *Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.*
- *Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak dhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.*
- *Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.*

*Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.*

- *Në çdo rast, përpara publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.*

- *Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.*

III.1.3. Nga shqyrtimi i dokumenteve të tenderit, në Shtojcën 7 të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

### **Shtojca 7**

*[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]*

#### **DEKLARATË**

**Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit të konsulentit**

*Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti/Enti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.*

*Në bazë të parashikimeve të neneve 41 dhe 54 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Unë i nënshkruari \_\_\_\_\_, në cilësinë e anëtarit të stafit të Konsulentit “.....” për procedurën e prokurimit me objekt \_\_\_\_\_ nën përgjegjësinë time personale, Deklaroj se:*

*1. Autorizoj VETËM Konsulentin “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë \_\_\_\_\_ nga Autoriteti/Enti Kontraktor \_\_\_\_\_ me objekt \_\_\_\_\_ me fond limit \_\_\_\_\_.*

*Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo konsulenti tjetër, për procedurën e prokurimit me objekt \_\_\_\_\_, është i pamiratur dhe pa pëlqimin e personit tim.*

*2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.*

*3. Nuk ndodhem në kushtet e konfliktit të interesit, me asnjë nga anëtarët e stafit të autoritetit/entit kontraktor, drejtpërdrejtë ose jo, i përfshirë në ndonjë pjesë të përgatitjes së kushteve të kontratës dhe/ose në procesin e përzgjedhjes për këtë kontratë dhe/ose për mbikëqyrjen e kësaj kontrate.*

*Data e dorëzimit të deklaratës \_\_\_\_\_*

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

III.1.4. Nga verifikimet e kryera në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik “A&E ENGEENERING” SHPK në përmbushje të kriterit të sipërpërmendur ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë vijon:

Shtojcën 12 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, sipas të cilës shoqëria “A&E ENGEENERING” SHPK deklaron se:

**B: DEKLARATË**

*Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)*

<b><i>Deklarata</i></b>	<b><i>Përgjigje</i></b>
<p><i>Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:</i></p> <p><i>Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti/enti kontraktor.</i></p>	<p><u><i>Punonjës</i></u></p> <p><i>Po [X] Jo [ ]</i></p> <p><i>Nëse, po, numri i punonjësve: 38 të punësuar (Disponoj numrin minimal të punonjësve / 10 punonjës të kërkuar sipas DST)</i></p> <hr/> <p><i>Profili i punonjësve</i> <b><u>STAFI KRYESOR</u></b></p> <ol style="list-style-type: none"><li><i>1. <u>Drejtues Projekti - Inxhinier Ndertimi/strukturist</u> - M. H (Licencë Mbikëqyrje; Diplomë; Kontratë Pune; CV ; Libreze pune)</i></li><li><i>2. <u>Mbikëqyrës per punimet topografike – F. D</u> (Licencë Mbikëqyrje; Diplomë; Kontratë Pune; CV; Libreze pune)</i></li><li><i>3. <u>Mbikëqyrës per punimet tjeologjike – V. A</u> (Licencë Mbikëqyrje; Diplomë; Kontratë Pune; CV; Libreze pune)</i></li><li><i>4. <u>Mbikëqyrës per punimet e sinjalistikes – K. D</u> (Licencë Mbikëqyrje; Diplomë; Kontratë Pune; CV; Libreze pune)</i></li></ol>

	<p>5. Mbikëqyrës per punimet hidroteknike – E. C (Licencë Mbikëqyrje; Diplomë; Administratore; CV; Libreze pune)</p> <p>6. Mbikëqyrës për punimet e mjedisit – A. K (Licencë Mbikëqyrje; Diplomë; Kontratë Pune; CV; Libreze pune)</p> <p>E. Sh (Licencë; Diplomë; VNM Kontratë Pune; CV; Libreze pune)</p> <hr/> <p><u>Makineri e mjete</u></p> <p>Po [ ] Jo [ ]</p> <p><u>Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:</u></p> <hr/>
--	---

Gjithashtu është dorëzuar Shtojca 7 “Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit të konsulentit” për secilin prej anëtarëve të stafit kryesor të deklaruar në Shtojcën 12 të sipërpërmendur.

III.1.5. Në nenin 77 te ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.

Në procedurat e prokurimit për shërbime, ku është e nevojshme që operatorët ekonomikë të kenë një autorizim të veçantë ose të jenë anëtarë të një organizate të veçantë për të kryer shërbimin në fjalë në shtetin e tyre të origjinës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë atyre të vërtetojnë se e kanë këtë autorizim ose anëtarësim.

3. Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Xhiron vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.

Kur një kontratë ndahet në lote, ky nen zbatohet për çdo lot individual. Megjithatë, autoriteti ose enti kontraktor mund të përcaktojë xhiron vjetore minimale që u kërkohet operatorëve, duke iu referuar grupeve të loteve, në rast se ofertuesi i suksesshëm merr disa lote që duhet të zbatohen në të njëjtën kohë.

Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale llogaritet mbi bazën e përmasave maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”.

Në pikat 1 dhe 2 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të LPP-së përcaktohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastiit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit.

*Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.*

*2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të garantuar zbatimin korrekt të procedurës.”.*

*Në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.*

*III.1.6. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.*

*2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:*

*a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;*

*b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;*

*c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;*

*ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;*

*d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;*

*dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;*

*e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;*

*ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;*

*f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;*

*g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;*

- gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;
  - h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);
  - i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;
  - j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;
  - k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.
3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash
6. Në çdo rast, përpara se të japë kontratën, autoriteti/enti kontraktor duhet t'i kërkojë ofertuesit fitues që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqitur në procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.
7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Në nenin 54, pikat 1, 5, 9 dhe gërma “a” e pikës 11 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “1. Shërbim konsulence është një procedurë prokurimi me faza, e cila përdoret në rrethanat e parashikuara në nenin 50 të LPP-së, për shërbime të një natyre intelektuale dhe/ose këshilluese.

5. Njoftimi i kontratës për shërbimin e konsulencës hartohet dhe publikohet në sistemin e prokurimeve elektronike dhe në Buletinin e Njoftimeve Publike. Ky njoftim përshkruan nevojat dhe kërkesat e autoritetit/entit kontraktor, karakteristikat e kontratës dhe kriteret minimale të përzgjedhjes së kandidatëve. Njësia e prokurimit apo edhe struktura të specializuara duhet të hartojnë projektkontratën me përkufizime të qarta të objektivave, qëllimeve dhe të synimit të detyrës në fjalë dhe dokumentet e tenderit. Çdo operator i interesuar ekonomik mund të dorëzojë një kërkesë për pjesëmarrje në fazën e parë të kualifikimit, duke dhënë informacionin që kërkohet, nga autoriteti/enti kontraktor.

9. Përcaktimet e parashikuara në këtë nen janë njësoj të zbatueshme për konsulentin, si person fizik ose juridik, për stafin e konsulentit dhe nënkonsulentët, si dhe për bashkimet e konsulentëve. Konsulentët mund të bashkohen me njëri-tjetrin, në formën e një bashkimi konsulentësh ose me një marrëveshje nënkonsulence, për plotësimin e fushave të tyre përkatëse të ekspertizës për fuqizimin e anës teknike të propozimeve të tyre dhe për vënien në dispozicion të një ekipi më të



*madh ekspertësh, për të ofruar propozime më të mira dhe, në disa raste, për të ofruar çmime më të ulëta. Një bashkim i tillë mund të krijohet për një afat të gjatë, pavarësisht nga detyra specifike ose mund të krijohet edhe për një detyrë të veçantë. Në çdo rast, ky bashkim duhet të dokumentohet me një kontratë të lidhur. Në rastin e bashkimit të konsulentëve secili prej tyre duhet të plotësojë kriteret detyruese për kualifikim sipas nenit 76, të LPP-së, ndërkohë kërkesat për kualifikim sipas përcaktimit në nenin 77, të LPP-së, dhe këto rregulla plotësohen bashkërisht nga i gjithë bashkimi.*

*11. Hapat e procedurës së shërbimit të konsulencës janë:*

- a) Në fazën e parë të kualifikimit, autoriteti/enti kontraktor përgatit preventivin e kostos dhe buxhetit, të cilat janë pjesë e njoftimit të kontratës. Preventivi i kostos bazohet në vlerësimin që autoriteti ose enti kontraktor u bën burimeve që i nevojiten për të përmbushur detyrën: kostoja për stafin, mbështetja logjistike dhe inputi fizik. Kostot duhet të ndahen në dy kategori kryesore:
  - i. tarifat (ose shpërblimi);*
  - ii. rimbursimet.**

III.1.7. Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit.

III.1.8. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimes, rezulton, se në dokumentet e tenderit autoriteti kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues për plotësimin e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3. të Shtojcës 11 të dokumenteve të tenderit duhet të deklarojë në Seksionin B “*DEKLARATË ‘Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)*” të Shtojcës 12 “*Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit*” se disponon në stafin inxhinierik të nevojshëm për kryerjen e shërbimit objekt-prokurimi, si në vijim: “*inxhinier ndërtimi/strukturist me licencë dhe me eksperiencë pune në mbikëqyrje në rolin*

*e drejtuesit të projektit; mbikëqyrës për punimet topografike, që duhet të jetë inxhinier topograf / gjeodet me licencë dhe me eksperiencë pune në këtë fushë; mbikëqyrësin për punimet e sinjalistikës, që duhet të jetë inxhinier mekanik me licencë dhe me eksperiencë pune në këtë fushë; mbikëqyrësin për punimet e drenazhimit dhe mbrojtjes lumore, që duhet të jetë inxhinier hidroteknik me licencë dhe me eksperiencë pune në këtë fushë dhe mbikëqyrësin për punimet e mjedisit, që duhet të jetë inxhinier mjedisi me licencë dhe me eksperiencë pune në këtë fushë .”.* Kriteri kualifikues i sipërpërmendur konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 12 të dokumenteve të tenderit objekt-prokurimi si dhe paraqitjes së shtojcës nr. 7 *“Deklaratën, Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit të konsulentit”* për secilin prej anëtarëve të stafit të deklaruar. Nga verifikimi në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton, se operatori ekonomik ankimues *“A & E ENGINEERING”* SHPK ka deklaruar në ofertën e tij, nëpërmjet formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 12, se disponon në stafin e tij për plotësimin e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.3 të shtojcës 11 përkatësisht *z. M. H me eksperiencë pune në mbikëqyrje në rolin e drejtuesit të projektit; znj. F. D në rolin e mbikëqyrëses për punimet topografike; z. V. A në rolin e mbikëqyrësit për punimet gjeologjike; z. K. D në rolin e mbikëqyrësit për punimet e sinjalistikës; znj. E. C në rolin e mbikëqyrëses për punimet hidroteknike; z. A. K dhe znj. E. Sh në rolin e mbikëqyrësve për punimet e mjedisit.”.* Gjithashtu, për secilin prej personave të stafit inxhinierik të deklaruar më sipër, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur deklaratën e secilit prej tyre të sipas shtojcës 7 të dokumenteve të tenderit objekt-ankimimi.

III.1.9. Referuar sa më sipër KPP vëren, se autoriteti kontraktor ka përcaktuar, se kriteri kualifikues i përcaktuar në pikën 2.3.3 të shtojcës 11 të dokumenteve të tenderit konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas shtojcës 12 të dokumenteve standarde të tenderit, si dhe paraqitjes së shtojcës 7 lidhur me disponueshmërinë e stafit që ka deklaruar në shtojcën 12 dhe që do të angazhojë për kryerjen e shërbimeve objekt-prokurimi që ka marrë përsipër të realizojë, gjë të cilën operatori ekonomik ankimues e ka përmbushur nëpërmjet deklarimit të stafit inxhinierik në Shtojcën 12 *“FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT”* dhe të deklarimit të disponueshmërisë të secilit prej anëtarëve të këtij stafi inxhinierik sipas shtojcës 7 *“Deklaratën, Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit të konsulentit”* të kërkuar në kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.3 të shtojcës 11 të dokumenteve të tenderit, si dhe të dorëzimit të këtyre shtojcave në dokumentacionin e ofertës. Autoriteti kontraktor në kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.3, të Shtojcës 11 të dokumenteve të tenderit, nuk ka kërkuar që operatori ekonomik të deklarojë se stafi inxhinierik, që disponon dhe që do të angazhojë për kryerjen e shërbimit objekt-prokurimi nuk duhet të jetë i deklaruar dhe i angazhuar në kontrata të cilat janë në proces zbatimi. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga shoqëria ankimuese *“A & E ENGINEERING”* SHPK dhe konkretisht i Shtojcës 12 *“FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT”*, si dhe shtojcave 7 *“Deklaratën, Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit të konsulentit”* për përmbushjen e kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.3 lidhur me disponimin e stafit inxhinierik të nevojshëm për kryerjen e shërbimit objekt-prokurimi, si në vijim: *“inxhinier*

*ndërtimi/strukturist me licencë dhe me eksperiencë pune në mbikëqyrje në rolin e drejtuesit të projektit; mbikëqyrës për punimet topografike, që duhet të jetë inxhinier topograf / gjeodet me licencë dhe me eksperiencë pune në këtë fushë; mbikëqyrësin për punimet e sinjalistikës, që duhet të jetë inxhinier mekanik me licencë dhe me eksperiencë pune në këtë fushë; mbikëqyrësin për punimet e drenazhimit dhe mbrojtjes lumore, që duhet të jetë inxhinier hidroteknik me licencë dhe me eksperiencë pune në këtë fushë dhe mbikëqyrësin për punimet e mjedisit, që duhet të jetë inxhinier mjedisi me licencë dhe me eksperiencë pune në këtë fushë .”.* KPP gjykon, se ka plotësuar kriterin kualifikues të sipërpërmendur, duke dëshmuar se disponon stafin inxhinierik të kërkuar.

Gjithashtu, autoriteti kontraktor ka përcaktuar, se kriteri kualifikues i përcaktuar në pikën 2.33, të Shtojcës 11 të dokumenteve të tenderit konsiderohet i përmbushur me plotësimin e shtojcës 12 “*FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT*” dhe shtojcës 7 “*Deklaratën, Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit të konsulentit*”, të dokumenteve të tenderit. Nga shqyrtimi në tërësi i dokumentacionit dhe informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor nuk rezulton që autoriteti kontraktor të ketë kërkuar dokumentacionin e stafit, të deklaruar nga ana e operatorit ekonomik ankimues, por meqënëse shoqëria ankimuese është përfituese e 3 (tre) kontratave po me këtë autoritet kontraktor dhe që janë në proces zbatimi, komisioni i vlerësimit të ofertave ka verifikuar deklaratimet e bëra nga ofertuesi në Shtojcën 12 “*FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT*”, duke konstatuar se z. M. H Drejtuesi Projektit është i angazhuar në kontratën nr. 3495/6 prot, datë 31.05.2022, me objekt: “*Supervizion Punimesh Ndërtim Rruga Korçë - Ersekë Loti 2 (pjesa e dytë), se znj. F. D, mbikëqyrëse për punimet topografike është e angazhuar në kontratën nr. 769/2 prot, datë 09.03.2023, me objekt “Plotësimi, rakordimi dhe vazhdimi i punimeve Sheshi Shqiponja - Lumi i Tiranës, Loti 1 dhe QMT”, si dhe se z. A. K mbikëqyrës për punimet e mjedisit është i angazhuar në kontratën nr. 3553/37 prot, datë 21.07.2023, me objekt: “LOTI 4 - KONTRATA "Supervizion mirëmbajtje me performance e akseve kryesore të Rajonit Jugor”, fakte të cilat autoriteti kontraktor e ka dhënë si argument në arsyen e skualifikimit të datës 24.05.2023, por pa identifikuar pjestarët konkret të stafit që janë deklaruar dhe që janë të angazhuar në këto kontrata.*

Lidhur me këtë arsye skualifikimi, ndonëse në kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.3, të Shtojcës 11 të dokumenteve të tenderit nga ana e autoritetit kontraktor nuk është përcaktuar që stafi inxhinierik nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, por është përcaktuar vetëm fakti se ky kriter konsiderohet i plotësuar vetëm me plotësimin dhe dorëzimin e Shtojcës 12 “*FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT*” dhe Shtojcës 7 “*Deklaratën, Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit të konsulentit*”, Komisioni i Prokurimit Publik nga shqyrtimi i Shtojcës 12 konstaton, se në pikën B “*Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)*” është përcaktuar se ofertuesit për stafin teknik që disponon dhe që kërkohen për të realizuar objektin e kontratës për të cilën oferton duhet të deklarojnë se: “*Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga*

*autoriteti/enti kontraktor.”, si dhe nga shqyrtimi i shtojcës 7 konstaton se në pikën 2 duhet të deklarohet se: “Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor”.*

Nga shqyrtimi i Shtojcës 12 “*FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT*” të dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues “*A & E ENGINEERING*” SHPK, Komisioni konstaton, se pika B e kësaj shtojce është plotësuar duke bërë deklaratimet e kërkuara, si dhe nga shqyrtimi i deklaratave të anëtarëve të stafit të bëra sipas Shtojcës 7 “*Deklaratën, Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit të konsulentit*”, konstaton se në pikën 2 secili prej tyre ka deklaruar se: “*Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor*”, ndërsa lidhur me arsyen e skualifikimit të datës 24.05.2023, Komisioni gjykon se arsyeja e skualifikimit e dhënë nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave me argumentin se *një pjesë e stafit të deklaruar në Shtojcës 12 “FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT” janë të angazhuar në kontratat në zbatim në ARRSH, nuk qëndron, pasi në pikën B të Shtojcës 12 dhe në pikën 2 të Shtojcës 7 të dokumenteve të tenderit nuk është parashikuar që të deklarohet që stafi inxhinierik të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera, por është parashikuar që të deklarohet se disponon stafin inxhinierik të nevojshëm dhe se secili prej anëtarëve të stafit inxhinierik ka deklaruar, se është i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor, duke e plotësuar kriterin kualifikues të përcaktuar në pikën 2.3.3, të Shtojcës 7 të dokumenteve të tenderit.*

Gjithashtu, lidhur me arsyen e skualifikimit të datës 24.05.2023, Komisioni gjykon, se arsyeja e skualifikimit e dhënë nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave me argumentin se *një pjesë e stafit të deklaruar në Shtojcës 12 “FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT” janë të angazhuar në kontratat në zbatim në ARRSH nuk qëndron, pasi referuar Ligjit 120/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar dhe në Udhëzim nr.3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, parashikohet se “Mbikëqyrës i punimeve” është personi fizik ose juridik, vendas apo i huaj, i licencuar për ushtrimin e mbikëqyrjes së punimeve, i cili ka përgjegjësi kontrollin e mbarëvajtjes së të gjithë procesit të zbatimit të punimeve në përputhje me projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, grafikun e punimeve, si dhe destinacionin e objektit, duke pasur parasysht edhe anën ekonomike të tij, si dhe nuk ka asnjë dispozitë ndaluese lidhur me angazhimin e stafit mbikëqyrës apo anëtarit të stafit të konsulentit.*

Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm. KPP gjykon, se arsyeja e skualifikimit për operatorin ekonomik në rastin konkret, nuk është në përputhje me kriteret e kualifikimit të vendosura nga autoriteti kontraktor për plotësimin e kapacitetit teknik, por në tejkalim të tij. Në këto kushte, Komisioni gjykon, se skualifikimi i operatorit ekonomik ankimues

nga ana e autoritetit kontraktor nuk është i drejtë. Në mënyrë eksplicite ligji për prokurimin publik parashikon, se vlerësimi i ofertave duhet bërë vetëm në përputhje me kriteret e kualifikimit të parashikuara në dokumentet e procedurës përkatëse. Vlerësimi i ofertave referuar kritereve të tjera të kualifikimit të cilat në asnjë rast nuk janë parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit, cenon parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit, parashikuar nga neni 3 i lex specialis, atë të barazisë në trajtimin e kërkesave dhe detyrimeve që i ngarkohen ofertuesve. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është me vend të theksojë rolin e posaçëm që ka autoriteti kontraktor, për vetëcilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje, se referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t'u siguruar nëse cilësia e mallrave është e njëjtë me cilësinë e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë. Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin, se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm.

Për sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “A & E ENGINEERING” SHPK qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos:**

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “A & E ENGINEERING” SHPK, për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur” me Nr. REF-73933-06-29-2023, me objekt: “Shërbim Konsulence”, me Nr. REF-64347-03-30-2023, me objekt: “Supervizion punimesh ‘Ndërtim rruga Berat - Ballaban, Loti 3’”, me fond limit 17.674.151,09 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 18.04.2023 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “A & E ENGINEERING” SHPK, duke e kualifikuar atë.

3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
  4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “A & E ENGINEERING” SHPK.
  5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
  6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**

